VENDIM
Nr. 64, datë 6.12.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 33, DATË 10.7.2019, "PËR LICENCIMIN E SHA UJËSJELLËS-KANALIZIME VAU-DEJËS"

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 "Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë" (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 "Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", e ndryshuar (rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 6.12.2019 pasi shqyrtoi çështjen me objekt "Mbi miratimin e projekt vendimit 'Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar nr. 33, datë 10.7.2019 'Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vau-Dejës"",

Vëren se:

1. Shoqëria Ujësjellës-Kanalizime Vau-Dejës (UK Vau-Dejës), me shkresën nr. 440 prot., datë 20.11.2019, me lëndë "Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit ligjor të sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vau-Dejës" ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesin ligjor, të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.
2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Vau-Dejës për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.
3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Vau-Dejës me vendimin nr. 33, datë 10.7.2019 "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vau-Dejës", me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura.
4. Drejtuesi ligjor i shoqërisë UK Vau-Dejës sh.a. z. Ilir Baba, ka mbaruar studimet e larta në juridik.
5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Vau-Dejës sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Vau-Dejës është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 33, datë 10.7.2019 "Për licencimin e sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Vau-Dejës" bëhen këto ndryshime:

"Drejtues ligjor: z. Ilir Baba".
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani